



Në bazë të nenit 8 (Planifikimit për prokurim) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042,  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit këtë:

## Udhëzimi Administrativ nr.01/2012

### DORËZIMI I PLANIFIKIMEVE PËR PROKURIM DHE I INFORMATAVE PLOTËSUESE

#### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që t'u ndihmojë autoriteteve kontraktuese në përgatitjen e planifikimeve përfundimtare për prokurim për Agjencinë Qendrore të Prokurimit siç parashihet në Nenin 8, paragrafi 2 në detaje të arsyeshme.

Ky udhëzim administrativ e plotëson Nenin 4 "Planifikimet për prokurim" të Udhëzimeve Operative për Prokurimin Publik

#### Neni 2 Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ e kanë kuptimin e përkufizimeve në Nenin 4 të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042.

#### Neni 3 Afati i planifikimeve

Planifikimi i prokurimit është proces i ndërmarrë nga secili Autoritet Kontraktues për të planifikuar aktivitetet e prokurimit për një periudhë kohore prej 12 (dymbëdhjetë) muaj. Planifikimi i prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese kryhet në dy faza:

1. Planifikimi paraprak dhe

## 2. Planifikimi final apo përfundimtar

Afati për dërgimin e planifikimeve paraprake për vitin fiskal 2013 do të dorëzohet në Agjencinë Qendrore të Prokurimit jo më më pak se 60 ditë para fillimit të vitit fiskal që do të thotë jo më vonë se më 01.11.2012.

Planifikimi final i prokurimit nga secili Autoritet Kontraktues, i cili është autoritet publik ose ndermarrje publike, duhet të përgatit dhe dorëzojë në AQP, me shkrim, Planifikimin Final të Prokurimit. Afati për dorëzimin e planifikimit final të prokurimit në AQP, është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2013.

### Neni 4 Planifikimet

Në mënyrë që të pranohen planifikimet me informata detaje të arsyeshme për shqyrtim dhe grumbullimit të informatave për Ministrinë e Financave, Agjencia Qendrore e Prokurimit kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që t'i kushtojnë vëmendje nivelit të detajeve që janë të nevojshme për identifikimin e produkteve të përdorimit të përbashkët. Formulari i planifikimeve kërkon klasifikimin e produkteve vetëm me anë të dy shifrave të para të CPV. Fatkeqësisht, ky informacion është i pamjaftueshëm për Agjencinë Qendrore të Prokurimit për ta bërë grumbullimin në nivel aq të detajuar që do të jetë i dobishëm për Qeverinë e Kosovës.

### Neni 5 Informatat plotësuese

Për vitin fiskal 2013 ne ju kërkojmë që, përveç planifikimeve standarde të prokurimit, të na dërgoni edhe informata plotësuese për tri kategori të cilat janë identifikuar gjatë viteve të kaluara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit si kategori potenciale për t'u centralizuar dhe kësi soji për ta kursyer buxhetin e shtetit. Përveç kursimeve, Autoritetet Kontraktuese do të përfitojnë duke e pasur një mënyrë më të lehtë për t'i prokuruar produktet e centralizuara nga ndonjë kontratë ekzistuese duke iu shmangur procedurave të mundimshme të tenderimit publik.

Tri kategoritë për të cilat Agjencia Qendrore e Prokurimit kërkon informata plotësuese janë:

1. Furnizim me derivate të naftës

## 2. Furnizim me material zyrtar

## 3. Furnizim me artikuj ushqimor

### Neni 6

#### Formulari për ofrimin e informatave plotësuese

Bashkëngjitur me këtë udhëzim administrativ është ofruar dhe formulari për dhënien e informatave plotësuese, nga një për secilën prej kategorive të përmendura në nenin 3. Ju lutemi plotësojeni fushën "Gjithsej shpenzimet e parashikuara në Eur 2013" përfshirë Tatimin në vlerën e shtuar si dhe të gjitha kontributet e aplikueshme në Kosovë.

Përveç kësaj, ne e kemi paraqitur edhe një shembull të formularit të plotësuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit për informatat plotësuese të saj.

### Neni 7

#### Afati për ofrimin e informatave plotësuese

Ne ju lusim që dokumentet e plotësuar me informata plotësuese t'ia dërgoni Agjencisë Qendrore të Prokurimit në të njëjtën kohë kur i dërgoni planifikimet përfundimtare për prokurim. Sipas nenit 8, paragrafi 2 i ligjit për prokurimin publik, planifikimet përfundimtare për prokurim duhet të dërgohen në Agjencinë Qendrore të Prokurimit brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit për përvetësimet për një vit fiskal.

### Neni 8

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prourimit Publik.


**Shtojcë: Formularin e Planifikimit të Prokurimit B01**, përgatitur nga AQP-ja në Microsoft Excel e shkarkoni në web faqen e KRPP-së të Legjislacioni sekondar. Autoritetet Kontraktuese do ta dorzojnë në AQP në formë elektronike përmes kësaj adrese:

**Planifikimiaqp@rks-gov.net**

Tel.kontaktues: +381 382 13 054 , ext.200 15 502

Më 19 12 2012  
Prishtinë



  
Kryetari i KRPP-së  
Safet Hoxha